



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN060720230001

Tiranë, më 31.07.2023

Komisioni 83

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “PËRFUNDI 2010” Sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L08028601E

Adresa e selisë: Kryqëzimi Stravaj - Golik, Banesë private pranë Urës Dritaj., Qukës

Personi përgjegjës: Qemal Përfundi

Për të zhvilluar projektin “**Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Zona kadastrale nr. 2969, zonë minerare nr 377, Pishkash, Njësia Administrative Qukës, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan.

Të dhëna teknike:

Sipërfaqe (sipas lejes): 0.099 km²

Lloji i mineralit: Gëlqeror

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet me rekomandimet si më poshtë vijon:

Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ushtrimit të aktivitetit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;

- Të spërkaten rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;

- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

- Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

• Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese sugjeron që zhvilluesi duhet të përmbushë detyrimet për menaxhimin e mbetjeve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, në fushën e mbetjeve, si më poshtë vijon:

• Gjatë këtij aktiviteti mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

• Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

• Të respektohen kërkesat e VKM nr. 418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

• Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të VKM nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

• Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.

• Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.

• Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

• Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet VKM nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

• Drejtoria e Natyrës dhe e Pyjeve sugjeron si më poshtë vijon:

- Sa i takon sektorit të pyjeve shprehet se: vlerësojnë se në çdo rast duhet pasur parasysh zbatimin me rigorizitetin e nenit 12, të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet” dhe ligjin nr.9693 datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor” gjithashtu duhet të realizojnë rehabilitimin sipas grafikut të punimeve dhe atë përfundimtar menjëherë pasi të mbarojnë punimet në këto sipërfaqe, sipas fazave të projektit që do të zbatohet.

- Sa i takon sektorit të mbrojtjes së natyrës shprehet: Sugjerohet që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet t’i përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve: Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar; Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëjë rehabilitimin e zonës me mbjellje pemësh.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. Të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku kërkon të zhvillohet aktiviteti “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”, Pishkash, Njësia Administrative Qukës, Bashkia Prrenjas, me zhvillues dhe aplikues “PERFUNDI 2010”, me nr. Aplikimi AN060720230001, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura

Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat-Elbasan-Korçë në mbështetje të VKM 686 date 29.07.2015 ka dërguar kërkesë për mendim pranë Bashkisë Prrenjas e cila nga ana e saj nuk ka kthyer përgjigje pozitive ose negative për zhvillimin e këtij aktiviteti. (Në sistem merret si Aprovim automatik në heshtje).

Nisur nga dokumentacioni i ardhur ARM Berat-Elbasan-Korçë shprehet parimisht dakord për vazhdimin e procedurave, dhe njëkohësisht është e mendimit që komisioni i VNM-së gjatë shqyrtimit të kërkesës së subjektit, të marrë parasysh edhe disa kushte të sugjeruara nga ana jonë:

1. Lagia e kantierit me ujë për shmangien e pluhurave sidomos gjatë kohës së thatë dhe me erë.
2. Sistemimi i skarpateve përfundimtare duke shfrytëzuar parametrat gjeomekanike dhe gjeometrike të tyre.
3. Gjatë shfrytëzimit të karrierës të zbatohet rehabilitimi progresiv i zonës që do të shfrytëzohet.
4. Mbushja, sistemimi, përpunimi dhe mbulimi i sipërfaqes që do të shfrytëzohet të behët hap pas hapi dhe në përfundim të aktivitetit.
5. Të zbatohet ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar.
6. Të zbatohet ligji nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar.
7. Të zbatohet ligji nr. 10463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

8. Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar.
9. Të zbatohet ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
10. Kontrollin e dherave të gjeneruara dhe mbeturinave jashtë standartit për blloqe dhe sistemimin e tyre.
11. Hapjen e kanaleve të nevojshëm me qëllim drejtimin e ujërave të shiut dhe erozionit për parandalimin e shëmbjes së sipërfaqes.
12. Shpërthimet të behen të kontrolluara dhe të kryhen në orare të përshtatshme.
13. Të zbatohet legjislacioni specifik në lidhje me zhurmat dhe me nivelet kufi të zhurmave.
14. Të mos ushtrojë aktivitetin natën.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye në datën 04.07.2023. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Takimi u mbajt pranë ambjenteve të subjektit, u diskutuan disa çështje, banorët nuk kishin asnjë shqetësimi rreth këtij subjekti, ata ishin dakort që ky subjekt të ushtrojë aktivitetin e tij. Nga ana e investitoreve iu siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. Çdo kërkesë e pjesëmarrësve, do të mbahej parasysh, në fazën kur shoqëria do të fillojë procedurat për fazën e shfrytëzimit.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 83, datë 31.07.2023, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.75, datë 07.04.2023, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- Akt - Miratim Nr 1757, datë 21.05.2015, midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me subjektin “Perfundit 2010” sh.p.k, “Zona minerare nr 377, në objektin Pishkash”, Librazhd, Qarku Elbasan.
- Mendimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
- 4.2** Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3** Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

- 4.4 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëj heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.** Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.
- 4.5** Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të veçantë.

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.6** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.7** Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9** Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10** Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12** Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13** Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.15** Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16** Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17** Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18** Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19** Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.20 Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.**
- 4.21 Personi përgjegjës teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.**
- 4.22** Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.23** Subjekti të respektoj dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.

- 4.24 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.25 Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.26 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojnë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodi citeti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	02.02.2024	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	02.02.2024	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	02.02.2024	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore	20-25 µg/m ³	02.02.2024	Çdo 6 muaj

(PM _{2.5})			
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	02.02.2024	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi AKM në	Periodicite ti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	02.02.2024	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Harta me Koordinatat (sipas e lejes minerere)

